# DËSHMI ARKIVI

**A-435311**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Gjykata italiane ul dënimin për ish-të dashurin e 13-vjeçares shqiptare, e cila humbi jetën 2 vite më parë, reagon ashpër familja – Vizion Plus |
| ADRESA | `https://www.vizionplus.tv/gjykata-italiane-ul-denimin-per-ish-te-dashurin-e-13-vjecares-shqiptare-e-cila-humbi-jeten-2-vite-me-pare-reagon-ashper-familja/` |
| BURIMI | vizionplus.tv |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 10 shtator 2026, 15:35:28 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 10 shtator 2026, 15:31:45 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `f6dbdbd7e4c62cfa3874adf6348811591e6882d99130dec87a07adfbb9f861df` |
| TEKSTI | `556a33792f4eee531894dcd73b99842b32563eb6c575b0a66357d252c3ce97c2` |
| PAMJA | `cb8c12b5f946ff0a722f0204df680ab98a6d775b3ff6ad96ec85e83daa354641` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `b821c87e559a9f1798f01f8633dc92f79ad7dd3ddb518b91f693fb6f405fd53a` |
| E MËPARSHMJA | `8df2d555ac64eeec2838dc09e12bdea06fef542ff1d40ba73e91de55b8e5eb50` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/b821c87e559a9f1798f01f8633dc92f79ad7dd3ddb518b91f693fb6f405fd53a`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

5 Nafta "kapërcen" 230 lekë për litër, ekspertët: Gabimi që na bën të kemi...

Vendimi i Gjykatës së Apelit në Bolonjë për të ulur dënimin nga 17 në 15 vite burg për ish-të dashurin e 13-vjeçares shqiptare Aurora Tili ka shkaktuar zemërim te familjarët.

NEWSLETTER

**Përmbledhja e ditës në e-mail**

emaili juaj

Abonohu

Adoleshenti, i cili ishte 15-vjeç në kohën kur ndodhi ngjarja tragjike, është duke u gjykuar nga sistemi i drejtësisë për të mitur.

Kujtojmë që Aurora Tili humbi jetën pasi ra nga ballkoni i banesës më 25 tetor 2024, në Piacenza të Italisë, ndërsa ish-i dashuri i saj u akuzua si shkaktar i kësaj tragjedie.

Avokati i nënës së Aurorës, Emilio Malaspina, tha se familja është veçanërisht e pakënaqur me kërkesën për uljen e dënimit, ndërsa e cilësoi 13-vjeçaren si viktimën më të re të femicidit në Evropë.

Reagimi më i ashpër ka ardhur nga nëna e saj, Morena Corbellini, e cila ka kundërshtuar vendimin e gjykatës.

"Atëherë presim që shkalla e vrasjeve të femrave të ulet? Ato vetëm do të rriten, dhe të miturit gjithashtu do të vrasin gjithnjë e më shumë, derisa vendi të ndërhyjë me forcë dhe në mënyrë korrekte. Gjërat vetëm sa do të përkeqësohen; dënimet jepen lehtë", është shprehur ajo.

Familja e Aurorës kërkon një qasje më të ashpër ndaj rasteve të dhunës ndaj grave dhe të miturve, ndërsa nëna e viktimës ka kërkuar ndërhyrje institucionale përballë rasteve të femicidit.

Ngjarja që tronditi Italinë ndodhi më 25 tetor 2024 në Piacenza, ku Aurora

Tili humbi jetën pas rënies nga ballkoni. Çështja vijon të jetë në qendër të vëmendjes për shkak të moshës së viktimës dhe të autorit të dyshuar në kohën e ngjarjes.

Vendimi i Gjykatës së Apelit të Bolonjës për uljen e dënimit nga 17 në 15 vite ka rikthyer debatin mbi trajtimin e të miturve të përfshirë në vepra të rënda penale dhe mbi masat që duhet të ndërmerren për parandalimin e femicidit.

#aurora #Gjykata #Italiane #tili #VizionPlus

**Taulant Halili**
Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

## Vazhdo të lexosh



KRONIKË

**Breshëria e plumbave në Mat, kush ishte...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 14:17



KRONIKË

**Mesazh me plumba ndaj një gruaje?!...**

Xhuljana Zhuleku · Dje 12:19




KRONIKË

**Shpërthimi me tritol në Shkodër, policia j...**

Taulant Halili · Dje 00:27



© 2026 Vizion Plus · Të gjitha të drejtat e rezervuara



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.